

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** sipas gjyqtarit individual Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarës L.S., nga fshati ... Komuna e ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për krime të përgjithshme PP.II.nr. 1330/2018 të datës 30.08.2018, më datën 30.08.2018 bie këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për krime të përgjithshme, për dhënjen e urdhërit ndëshkimor ndaj të akuzuaraes :

**L.(K.) S.**, e lindur me datën 10.06.1972, në fshati ..., me numër personal ..., e leshuara nga shteti Gjerman, me banim në fshatin ..., Komuna e ..., shqiptare, shtetase e Gjermanisë.

## Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse më datën 24.08. 2018, rreth orës 19:00 minuta, në fshatin ..., Komuna e Novobërdës, e pandehura L.S., ka rrezikur trafikun publik duke venë në rrezikë jeten e njerzve dhe pasurin e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar atomjetin e sajë të markës BMW me targa ..., nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispoziten ligjore 73 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për rregullim e trafikut rrugorë, në bazë të së ciles në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut vozitësja synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, lejohet të fillojë një veprim të tillë nëse më para është e bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesmarrsit tjerë në trafik, ose nuk e rrezikon pasurin, kështu që e njejta duke bërë tejkalimin e automjetit që kishte përpara duke parë rrezikun nga një kamioni nga kahja e kundërt në përballë kalim, shmanget në anën e majtë të lëvizjes, shkeputet nga rruga, dhe me atë rastë godet shtyllen elektrike duke përfunduar jashtë rruges, dhe nga ky aksident, përveq dëmit material në automjet, lëndime trupore pësojnë edhe vet e pandehura dhe G.S.1., G.S.2., A.S., të cilët për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohen të kerkojnë ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së,

Andaj Gjykata në bazë të nenëve 4, 41, 46, 73, të KPK-së, dhe neneve 365 dhe 495 të KPPK-ës, të akuzuara Luljetë Sejdiu ,

## E D E N O N

Me denim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqindë euro), të cilën gjobë e akuzuara L.S., do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do të ia zëvendësoi me denim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 Euro për një ditë burgimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e akuzuara që të paguaj paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 € (njëzet), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për krime të përgjithshme, me aktakuzën e vet PP.II.nr. 1330/2018 të datës 30.08.2018, ka akuzuar L.S., nga fshati ... Komuna e ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, dhe ka propozuar që pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të jepet urdhëri ndëshkimor sipas të cilit të akuzuara do të shqiptohet dënimi me gjobë.

Pas shqyrtimit të aktakuzës dhe kërkesës për urdhër ndëshkimor, Gjykata në bazë të provave të bashkangjitura, ka gjetur se kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe shqiptimit të dënimit me gjobë është e bazuar, dhe ofrojnë elemente të mjaftueshme për marrjen e aktgjykimit për pranimin e urdhërit ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor konform nenit 493 par.1 dhe 495 të KPPK-së.

Nga kallzimi penal të paraqitur nga ana e Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Gjilan – Njësa i Trafiku Regjional, me nr. të rastit 2018-CR-513, EN:188/137 të datës 24.08.2018 shihet se e akuzuara L.S., më datën 24.08.2018, rreth orës 19:00 minuta, në fshatin ..., Komuna e Novobërdës, e pandehura L.S., ka rrezikur trafikun publik duke venë në rrezikë jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar atomjetin e sajë të markës BMW me targa ..., nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispoziten ligjore 73 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për rregullim e trafikut rrugorë, në bazë të së cilës në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut vozitësja synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, lejohet të fillojë një veprim të tillë nëse më para është e bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik, ose nuk e rrezikon pasurin, kështu që e njehta duke bërë tejkalimin e automjetit që kishte përpara duke parë rrezikun nga një kamioni nga kahja e kundërt në përballë kalim, shmanget në anën e majtë të lëvizjes, shkaputet nga rruga, dhe me atë rastë godet shtyllen elektrike duke përfunduar jashtë rruges, dhe nga ky aksident, përveq dëmit material në automjet, lëndime trupore pësojnë edhe vet e pandehura dhe G.S.1., G.S.2., A.S., të cilët për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

Mbështetur në gjendjen faktike dhe në bazë të provave të bashkangjitura Gjykata ka gjetur se me veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën të njejtin e ka shpallur fajtores dhe e ka dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së denimit për të akuzuarën L.S., në kuptim të nenit 73 të KPK-ës, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe të akuzuarës i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me një denim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-ës, dhe se një denim i tillë është në përpjestim me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450 dhe 453, të KPPK-së.

Kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në nenin 458 paragrafi 2 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,  
Departamenti i Përgjithshëm  
Më. 30.08.2018**

**Bashkëpunëtorja profesionale,  
Shqipe Kastrati d.v**

**Gj y q t a r i,  
Behar Ymeri d.v**

**Këshilla juridike:** kunder këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim, ne afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të të njejtin, kundërshtimi dorëzohet në dy ekzemplarë në këtë Gjykatë.